


Barazia në letër, jo në praktikë: (mos) përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në politikëbërje



Barazia në letër, jo në praktikë

Dhjetor 2024

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	01
Hyrje	02
Obligimet ligjore dhe kërkesat ndërkombëtare	04
Sa janë të qasshme të dhënat e ndara sipas gjinisë në Kosovë?	06
Cilat institucione publike integrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në procese buxhetore?	09
Përfundime dhe rekomandime	15

Përmbledhje ekzekutive

Të dhënat e ndara sipas gjinisë luajnë një rol të pazëvendësueshëm në formësimin e politikave që synojnë barazinë dhe drejtësinë sociale. Gratë përbëjnë 50% të popullsisë në Kosovë, andaj të dhëna të tilla janë thelbësore për të kuptuar më mirë nevojat specifike të tyre dhe për të zhvilluar politika që adresojnë këto nevoja në mënyrë të drejtë dhe efektive. Të dhënat ndihmojnë në identifikimin e pabarazive strukturore midis burrave dhe grave dhe theksojnë sfidat unike që përballen gratë në fusha të tilla si arsimi, punësimi dhe shëndetësia.

Në Kosovë ekzistojnë tri probleme kryesore lidhur me të dhënat e ndara sipas gjinisë: (mos) ekzistenca dhe publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë; (mos) përdorimi i këtyre të dhënave në hartimin e politikave; dhe përdorimi i të dhënave vetëm për të përmbushur kërkesat formale, pa i zbatuar ato për të adresuar probleme ose përmirësuar politikat.

Ndarja e të dhënave sipas gjinisë në Kosovë, përveçse një praktikë e dobishme, është edhe kërkesë ligjore e përcaktuar nga Ligji për Barazi Gjinore, i cili kërkon integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e politikëbërjes. Ndërkohë që ekzistojnë përpjekje për të mbledhur të dhëna të ndara sipas gjinisë, mungesa e vetëdijësimit si dhe e kapaciteteve dhe kulturës institucionale, që priorizon barazinë gjinore paraqet sfida të rëndësishme. Pavarësisht disa përpjekjeve institucionale, në Kosovë ende mungojnë statistika të përditësuara dhe të dhëna të përmbledhura në mënyrë sistematike për qëllime buxhetore dhe vlerësime të ndikimit gjinor.

Nga vlerësimi i kryer në kuadër të këtij raporti rezulton se disa institucione të nivelit qendror, si Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme ofrojnë më shumë informacion të bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë, disa prej tyre si Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ofrojnë vetëm të dhëna të pjesshme; ndërsa disa nga institucionet si Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk publikojnë asnjë të dhënë të ndarë sipas gjinisë. Për më tepër, Kosova akoma nuk ka një indeks të barazisë gjinore, sipas kërkesave të Bashkimit Evropian.

Sa i përket përfshirjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë në proceset buxhetore, Instituti GAP identifikoi se dokumentet buxhetore kryesore shpesh nuk përmbajnë masa të qarta për përmirësimin e barazisë gjinore. Dokumentet si buxheti vjetor, korniza afatmesme e buxhetit, apo plani vjetor janë të kufizuara në këtë aspekt, dhe mungojnë analizat e ndikimit gjinor. Komunat zakonisht ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë vetëm si pjesë e kërkesave për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (32% për vitin 2024). Ndërsa sa i përket raporteve vjetore, 30.5% e institucioneve të pavarura dhe 11% e institucioneve qeveritare të nivelit qendror kanë përfshirë në to të dhëna të ndara sipas gjinisë. Asnjë nga komunat nuk ka përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë në planin e tyre vjetor.

Ndërsa, edhe ndërmarrjet publike në Kosovë nuk publikojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë përpos pjesëmarrjes në borde dhe menaxhmentit të lartë, duke pamundësuar vlerësimin e barazisë gjinore dhe hartimin e politikave efektive në këtë drejtim. Edhe pse Ligji për Barazi Gjinore parasheh sanksione për institucionet publike të cilat nuk mbledhin, përpunojnë dhe dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës të dhënat e ndara sipas gjinisë, deri sot nuk është evidentuar ndonjë ankesë apo padi administrative për këtë çështje.

Hyrje: Pse është e rëndësishme ndarja e të dhënave sipas gjinisë?

Shumë prej sistemeve ekzistuese, nga institucionet politike deri te strukturat e vendit të punës, janë ndërtuar nga një këndvështrim i dominuar nga burrat, duke sjellë politika që favorizojnë burrat më shumë se gratë¹. Gratë përbëjnë 50% të popullsisë së Kosovës, andaj roli i të dhënave të ndara sipas gjinisë është i pazëvendësueshëm në krijimin e politikave që synojnë barazinë dhe drejtësinë sociale.^{2,3} Në një shoqëri që përballlet me sfida të mëdha sociale dhe ekonomike, veçanërisht për gratë, përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë bëhet thelbësor për të kuptuar më mirë nevojat specifike të grupeve të ndryshme dhe për të ndërtuar politika që adresojnë këto nevoja në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Të dhënat për individët mund të klasifikohen sipas gjinisë, duke krijuar kështu bazën për statistikat e ndara sipas gjinisë, të cilat pasqyrojnë situatat e grave dhe burrave si dhe sfidat e politikave të lidhura me gjininë⁴. Megjithatë, statistikat gjinore përfshijnë më shumë se ndarjen e të dhënave sipas gjinisë. Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk garantojnë gjithmonë se konceptet, përkufizimet dhe metodat e përdorura për prodhimin e tyre janë të dizajnuara për të reflektuar rolet gjinore, marrëdhëniet dhe pabarazitë në shoqëri⁵.

Një nga përparësitë kryesore nga ndarja e të dhënave sipas gjinisë është se ato ndihmojnë në identifikimin e dallimeve strukturore mes burrave dhe grave, si dhe në evidentimin e sfidave unike me të cilat gratë përballen në vendimmarrje si dhe fusha si arsimi, punësimi, shëndetësia. Roli tradicional gjinor, që përforcohet nga normat kulturore, shpesh nuk sfidohet nga politikat, duke çuar në një situatë ku burrat përfitojnë më shumë nga politikat që ruajnë status quon⁶. Për shembull, nëse statistikat tregojnë se shkalla e papunësisë është më e lartë tek gratë krahasuar me burrat, atëherë kjo tregon një hendek të qartë që kërkon ndërhyrje specifike. Politikrat që synojnë reduktimin e papunësisë pa marrë parasysh dallimet gjinore mund të rezultojnë joefektive në përmirësimin e pozitës së grave në tregun e punës. Shembull i kësaj është hendeku gjinor në paga. Pavarësisht kualifikimeve të ngjashme, gratë shpesh marrin paga më të ulëta se burrat për të njëjtën punë⁷. Ky dallim në pagë përforcohet nga politika që nuk adresojnë diskriminimin sistematik.

Një tjetër arsye pse këto të dhëna janë kaq të rëndësishme është mundësia për të krijuar politika më të drejta dhe të përshtatshme. Kur politikëbërësit kanë informacion të detajuar për përvojat dhe situatat e ndryshme të grave dhe burrave, ata janë më të aftë të hartojnë politika që i përgjigjen realitetit. Për shembull, nëse të dhënat tregojnë se gratë kanë më pak qasje në shërbime shëndetësore, atëherë ky informacion mund të shërbejë për të zhvilluar programe të posaçme që lehtësojnë këtë qasje dhe përmirësojnë kushtet e kujdesit shëndetësor për gratë.

¹ Bohnet, I. Cfarë funksionon: Brazia Gjinore sipas dizajnit [What works: Gender Equality by Design], 2016.

² ASK. Rezultatet paraprake të regjistrimit të popullësisë, 2024.

³ Criado Perez, C. Gratë e Padukshme [Invisible Women], 2019.

⁴ EIGE. Gender Equality Index: Measuring progress in the Western Balkans. Office of European Union, 2023.

⁵ Ibid

⁶ Instituti GAP. Diskriminimi me bazë gjinore në shpalljet e vendeve të lira të punës, 2023.

⁷ Ibid

Përveç kësaj, të dhënat e ndara sipas gjinisë janë të rëndësishme për të matur efektin e politikave në përmirësimin e barazisë gjinore. Politikat publike shpesh duken të barabarta në letër, por efektet e tyre mund të jenë të pabarabarta për grupet e ndryshme në shoqëri.⁸ Përmes të dhënave të ndara sipas gjinisë, mund të matet nëse përfitimet e këtyre politikave shpërndahen në mënyrë të drejtë mes grave dhe burrave me sfond të ndryshëm. Shembulli i kësaj mund të jetë përgjigja e Qeverisë së Kosovës ndaj pandemisë COVID-19. Një analizë fiskale gjinore e Rrjetit të Grave të Kosovës nxjerr në pah efektin e ndryshëm që masat nga paraja publike mund të kenë tek gratë dhe burrat.⁹

Autorja Perez argumenton se si politikat shpesh favorizojnë burrat më shumë se gratë.¹⁰ Si shembull ajo përdorë politikat tatimore të Australisë për fonde penzioni. Hendeku gjinor në paga dhe në shkallën e punësimit, ndikon në pabarazi në fondet e pensionit nga i cili përfitojnë më shumë burrat se gratë.¹¹ Rrjeti i Grave të Kosovës po ashtu argumenton se duke mos marrë parasysh siç duhet dimensionet gjinore të sistemeve tatimore, tatimet mund të përforcojnë dhe përkeqësojnë pabarazitë gjinore.¹² Përdorimi i një mendësie neutrale ndaj gjinisë gjatë hartimit të politikave tatimore (dhe jo vetëm), mund të kontribuojë në rezultate të cilat pengojnë avancimin e barazisë gjinore, si dhe avancimin e të drejtave sociale dhe atyre ekonomike.¹³

Duke marrë parasysh historikun e pabarazisë dhe sfidat që përballojnë gratë në Kosovë, një qasje e bazuar në të dhëna i ndihmon institucionet të ndërtojnë politika më të përgjegjshme dhe të orientuara drejt përmirësimit të jetës së qytetarëve të saj. Për më tepër, institucionet akademike dhe organizatat joqeveritare dhe think tanks që përdorin hulumtimin si instrument avokimi drejt politikave më të drejta, shpesh hasin në problemin e mungesës së të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Andaj, Instituti GAP përmes kësaj analize ka identifikuar boshllëqet në zbatimin e kornizës ligjore, sfidat praktike, dhe ndikimin që mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë mund të ketë mbi politikat dhe zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës. Kjo është bërë duke analizuar kornizën ligjore të Kosovës dhe kërkesat ndërkombëtare, disponueshmërinë e të dhënave të ndara sipas gjinisë për palët e treta, si dhe duke analizuar përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në procese buxhetore.

⁸ Criado Perez, C. Gratë e Padukshme [Invisible Women], 2019.

⁹ RrGK. "Pandemia nuk njih gjini"? Analizë gjinore fiskale buxhetore: Reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 nga perspektiva gjinore, 2020.

¹⁰ Criado Perez, C. Gratë e Padukshme [Invisible Women], 2019.

¹¹ Ibid

¹² RrGK. Një rishikim i shpejtë i sistemit tatimor të Kosovës nga perspektiva gjinore dhe opsionet e politikave për tatim më të përgjegjshëm gjinor, 2022.

¹³ Ibid

Obligimet ligjore dhe kërkesat ndërkombëtare

Ndarja e të dhënave sipas gjinisë, përpos që është praktikë e nevojshme për politikëbërje më ekifase, është edhe obligim ligjor në Kosovë. Ligji për barazi gjinore (LBGj) obligon përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacionin në Kosovë.¹⁴ Ky ligj e përkufizon integritin gjinor si përfshirje e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, planifikimit, miratimit, zbatimit, përcjelljes dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave ose programeve dhe buxheteve, në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, duke pasur parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta mes burrave dhe grave.¹⁵ Përpos kornizës ligjore të Kosovës, integriti gjinor është edhe kërkesë e Komisionit Evropian.¹⁶

Mirëpo, zbatimi i këtyre detyrimeve shpesh has në pengesa si: mungesa e kapaciteteve të duhura institucionale, mungesa e vetëdijësimit për rëndësinë e këtyre të dhënave, si dhe kultura institucionale që shpesh nuk e priorizon këtë aspekt. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në hartimin e politikave efektive që promovojnë barazinë gjinore dhe mund të krijojë disbalanca në mundësitë dhe përfitimet që ofrohen për gratë dhe burrat në sektorë të ndryshëm.¹⁷ Për të targetuar mungesën e kapaciteteve institucionale dhe për të ndihmuar të gjithë akterët e përfshirë në fazat e secilës politikë ose program, në vitin 2019 ishte zhvilluar Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor (VNGj).¹⁸ Ky manual shërben si pikë referimi për kryerjen e një vlerësimi të ndikimit të barazisë gjinore të të gjitha politikave, programeve dhe aktiviteteve, duke përfshirë vlerësimet *ex ante*.¹⁹

Për zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e Manualit, gjatë viteve 2018 dhe 2019, ABGj kishte trajnuar 486 nëpunës civilë.²⁰ Gjatë kësaj kohe, 48 koncept dokumente qeveritare i janë nënshtruar vlerësimeve të ndikimit gjinor.²¹ Megjithatë, bazuar në një analizë të përgjegjshmërisë gjinore të menaxhimit të financave publike, ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve për zbatimin e duhur dhe të plotë të vlerësimeve të ndikimit gjinor.²²

Ndonëse institucionet e Kosovës mbledhin dhe mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, kjo nuk bëhet në mënyrë sistematike për të informuar planifikimin e buxhetit dhe ndarjen e burimeve.²³ Në disa raste kur të dhënat janë të mbledhura dhe raportuara, ndonjëherë mungon informacioni i detajuar dhe i ndarë sipas gjinisë për të adresuar sfida të caktuara. Për më tepër ka raste kur shifrat shpeshherë nuk janë të njësuara dhe ekziston një shpërputhje në të dhëna.²⁴ Edhe pse ka përpjekje për të adresuar pabarazitë gjinore, ndonjëherë politikat dhe ligjet nuk janë të mjaftueshme ose nuk zbatohen si duhet për të siguruar barazi të plotë dhe për të adresuar ndarjet gjinore në mënyrë efektive, pasi që të dhënat përdoren vetëm si numër e jo për të informuar hartimin e politikave.

¹⁴ Ligji 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 5, par 1.3.

¹⁵ Ligji 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 3, par 1.6.

¹⁶ Komisioni Evropian. Raporti i Kosovës 2024, f.6, 2024.

¹⁷ Zyra e Kryeministrit, ABGj. Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore.

¹⁸ Ibid

¹⁹ Ibid

²⁰ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022.

²¹ Ibid

²² Ibid

²³ RrGK. Monitorimi i zbatimit të indikatorit 5.c.1 të SDG-së në Kosovë, 2020.

²⁴ Instituti GAP. Profilet e Bizneseve: Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë, 2023.

Integrimi i perspektivës gjinore bëhet duke u bazuar në të dhëna, qofshin ato cilësore apo sasiore.²⁵ Ndarja e të dhënave sipas gjinisë është obligim ligjor që nga viti 2015. Neni 5 i LBGj thotë "Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative dhe masat tjera duke përfshirë ndarjen sipas gjinisë të të gjitha të dhënave të nevojshme statistikore, që mblidhen, regjistrohen, përpunohen dhe obligohen që këto të dhëna t'i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës".²⁶

Për më tepër, ndarja e të dhënave të ndara sipas gjinisë është praktikë ndërkombëtare duke përfshirë PEFA, direktivat e Bashkimit Evropian, dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Organizasës së Kombeve të Bashkuara, respektivisht treguesi 5.c.1 mes tjerash, kërkesat e të cilave Qeveria e Kosovës është zotuar të përmbushë.

PEFA është një metodologji për vlerësimin e performancës së menaxhimit financiar publik. Kuadri plotësues i PEFA-s për vlerësimin e menaxhimit financiar publik të ndjeshëm ndaj gjinisë (GRPFM) përfshin një grup prej nëntë treguesish që masin shkallën në të cilën sistemet e menaxhimit financiar publik të një vendi adresojnë qëllimet e qeverisë për të njohur nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, si dhe nëngrupeve të ndryshme brenda këtyre kategorive, dhe për të promovuar barazinë gjinore.²⁷ Vlerësimi i PEFA GRPFM bazohet në kapacitetin e institucioneve publike për menaxhim të burimeve të ndjeshëm ndaj gjinisë; shembull, kapaciteti i ministrive përkatëse për të kryer vlerësimin e ndikimeve gjinore dhe për të mbledhur dhe përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë është i domosdoshëm.²⁸ Për sa i përket disponueshmërisë së të dhënave, ky vlerësim ka konstatuar se mungesa e të dhënave në kohë cilësore por edhe cilësore pengon vlerësimet e duhura të ndikimit gjinor.²⁹

Rezultatet e vlerësimit për Kosovën tregojnë se kuadri ligjor përmbush kriteret, mirëpo institucionet relevante sipas GRPM nuk integrojnë perspektivën gjinore në procese të menaxhimit të financave publike. Ndërsa dy tregues të këtij vlerësimi tregojnë se gjinia është pjesërisht e integruar, pra, ndikimet gjinore nuk janë integruar plotësisht në asnjë nga nëntë fushat, sipas kriterëve.³⁰

²⁵ OSCE. Për një legjislacion efektiv, si për gratë, ashtu dhe për burrat: Udhëzues Praktik për Legjislacionin me Ndjeshmëri Gjinore, 2020.

²⁶ Ligji 05/L-020 për Barazi Gjinore, Neni 3, par 1.8.

²⁷ PEFA. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Gender Responsive Public Financial Management Assessment Report.

²⁸ Ibid.

²⁹ Ibid.

³⁰ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022.

Sa janë të qasshme të dhënat e ndara sipas gjinisë në Kosovë?

Qeveria e Kosovës ka sisteme elektronike për menaxhimin e të dhënave, që mundësojnë përpunim të saktë, mbikëqyrje efektive dhe qasje të lehtë e transparente, duke siguruar kontrollin e nevojshëm.³¹ Kjo e bënë shumë të lehtë ndarjen e të dhënave sipas gjinisë në rastet kur vullneti për të bërë këtë ndarje ekziston. Pra, edhe pse është obligim ligjor dhe ekziston infrastruktura për të bërë këtë ndarje, kjo praktikë mbetet në vullnetin e zyrtarëve publik.

Edhe pse Ligji për Barazi Gjinore parasheh sanksione për institucionet publike të cilat nuk mbledhin, përpunojnë dhe dorëzojnë në ASK të dhënat e ndara sipas gjinisë,³² deri sot nuk është evidentuar ndonjë ankesë apo padi administrative për këtë çështje.³³ Kosovës akoma i mungon një indeks i barazisë gjinore.³⁴ Indeksi i Barazisë Gjinore do të kontribuonte për harmonizimin e politikave kombëtare me acquis të BE-së për barazinë gjinore duke lejuar monitorimin dhe matjen e progresit të një shtetisipas standardeve të BE-së për barazi gjinore dhe politika prioritare.³⁵ Politikat prioritare të BE-së për barazinë gjinore përfshijnë mbylljen e hendekut gjinor në punësim dhe paga, balancimin e jetës profesionale dhe familjare, rritjen e përfaqësimit të grave në vendimmarrje, luftimin e dhunës me bazë gjinore, eliminimin e stereotipeve gjinore dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat ndërkombëtare.³⁶ Indeksi i Barazisë Gjinore ndihmon në matjen e progresit dhe harmonizimin e politikave kombëtare me standardet e BE-së.

Sipas vlerësimit të PEFA, përpjekjet e ABGj për të krijuar Indeksin e Barazisë Gjinore për Kosovën sipas BE-së kanë dështuar si pasojë e mungesës së të dhënave.³⁷ Raporti specifikon se mungojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në disa fusha kyçe, siç janë numri i të punësuarëve në institucione publike, pozitat udhëheqëse, subvencionet dhe grantet, si dhe pjesëmarrja gjinore në sektorë të ndryshëm si arsimit, shëndetësia dhe sektori privat.³⁸ Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë në Kosovë është ndesh edhe me Planin për Veprim Gjinor të BE (PVGj III).³⁹ Edhe Ligji për Statistikat Zyrtare zotohet në harmonizimin e Statistikave Zyrtare me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, ku përfshihet edhe Indeksi i Barazisë Gjinore.

ASK në vitet e kaluara ka publikuar raportin "Burrat dhe Gratë", publikim i cili përfshin të dhënat statistikore më afatgjata dhe me analiza të shkurtra, për të ndihmuar në perceptimin e situatës gjinore në vend. Mirëpo, raporti nuk përfshin të dhëna për barazinë gjinore apo ndonjë analizë mbi ndikimin e fondeve publike në barazinë gjinore.⁴⁰

³¹ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022.

³² LBGj, neni 23: "për kundërvajtje nga nenet 2, 3 dhe 5 të këtij ligji gjykata kompetente zhvillon procedure kundërvajtëse dhe shqipton sanksione". Paragrafi 5: "Gjobë në shumë prej treqind (300) deri në pesëqind (500) euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në subjektet nga neni 5 nën paragrafi 1.8 i këtij ligji nëse nuk grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore të ndara në bazë gjinore dhe nuk i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës".

³³ Intervistë me Agjencinë për Barazi Gjinore.

³⁴ Komisioni Evropian. Raporti i Kosovës 2024, f.6, 2024.

³⁵ EIGE. Gender Equality Index: Measuring progress in the Western Balkans. Office of European Union, 2023.

³⁶ Ibid.

³⁷ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022.

³⁸ Ibid.

³⁹ RrGK. Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE, 2022.

⁴⁰ ASK. Gratë dhe Burrat në Kosovë 2020-21, 2022.

Raporti i fundit Burrat dhe Gratë 2020-21, përfshinë të dhënat e ndara sipas gjinisë kryesisht për statistikat sociale si:

- popullsia: lëvizjet e popullsisë, piramida e popullsisë, kurorëzimet dhe shkurorëzimet, lindjet e gjalla;
- shëndetësia dhe mirëqenia: jetëgjatësia, vdekjet;
- arsimit: popullsia sipas nivelit të arsimit, analfabetët, numri i parashkollorëve, nxënësve dhe studentëve, struktura e mësimdhënësve;
- mbrojtja sociale: struktura e banimit kolektiv, fëmijët e braktisur, personat e moshuar pa përkujdesje familjare, pensionet, të punësuarit në institucione shëndetësore;
- jurisipodencia: gjyqtarët, personat e dënuar, viktimat nga dhuna familjare;
- tregu i punës: raporti i punësimit, të punësuarit, struktura e ndërmarrjeve, pronësia e tokave bujqësore;
- vendimmarrja: postet drejtueses në pozitat vendimarrëse, të punësuarit në administratë, të punësuarit në misione diplomatike, struktura në policinë e Kosovës, stafi ushtarak.

Gjithsesi, të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë plotësisht të mjaftueshme për publikun duke marrë parasysh se disa tregues kryesor nuk janë të ndarë tutje sipas vendodhjes, përkatësisë etnike apo ndarjeve të tjera demografike.⁴¹

GAP ka analizuar uebfaqet e institucioneve publike të nivelit qendror për të parë se cilat informata të ndara sipas gjinisë janë të qasshme online për publikun. Vlerësimi se a publikojnë të dhëna të plota apo pjesërisht ndryshon varësisht prej rolit të institucionit dhe llojit të të dhënave të cilat mund t'i posedojnë; shembull, Zyra e Kryeministrit (ZKM) mund të publikojë vetëm të dhëna rreth të punësuarve në kabinet dhe agjencitë në kuadër të ZKM.

Tabela 1. Publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë nga institucionet e nivelit qendror⁴²

Institucioni	Lloji i të dhënave të ndara sipas gjinisë
Ministria e Shëndetësisë	Numri i të punësuarëve/ave
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministria nuk publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë. Vetëm agjencitë në kuadër të kësaj ministrie publikojnë pjesërisht të dhëna të ndara sipas gjinisë (shembull: Adminsitratat Tatimore e Kosovës dhe Agjencia e Punësimit)
Ministria e Punëve të Brendshme	Numri i personave që posedojnë dokumente zyrtare (letërnjoftim, pasaporta, e të tjera); Numri i hyrjeve/daljeve nga territori i Kosovës; Numri i personave që kanë migruar nga/në Kosovë; Numri i personave të riatdhesuar; Numri i personave që posedojnë automjete; Numri i të punësuarëve/ave
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	Numri i nxënësve dhe studentëve; numri i mësimdhënësve; mungojnë pozitat udhëheqëse

⁴¹ RrGK. Integrimi i perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE, 2022.

⁴² Shënim: Janë analizuar vetëm të dhënat e qasshme online, pa kërkesë për qasje në të dhëna.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Nuk ka
Ministria e Mbrojtjes	Numri i rekrutëve të ri/reja; personeli i larguar
Ministria e Drejtësisë	Numri i të punësuarve në gjykatë, prokurori, mbrojtësit e viktimave; përfituesit e ndihmës juridike; dënimet; rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Përfituesit e subvencioneve dhe granteve
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Strategjia shtetërore për rininë 2024-2032 përfshinë të dhëna sipas gjinisë; mungojnë të dhëna për përfituesit e granteve dhe subvencioneve; numri i sportistëve, përfshirë ndarje tjera.
Zyra e Kryeministrit	Numri i të punësuarëve/ave në kabinet; të dhëna të ndryshme përmes ABGj
Zyra e Presidentes	Numri i të punësuarëve/ave në kabinet
Kuvendi i Republikës së Kosovës	Numri i të punësuarëve
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Pronësia e bizneseve përmes ARBK; mungojnë të dhënat e prokurimit dhe ndarja e granteve dhe subvencioneve.
Ministria e Ekonomisë	Pronësia dhe trashëgimia e pronave; mungojnë të dhëna për energjinë
Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal	Numri i të punësuarëve/ave në administratë publike
Ministria e Punëve të Jashtme	Nuk ka
Ministria për Komunitete dhe Kthim	Nuk ka
Ministria e Zhvillimit Rajonal	Nuk ka

Burimi: GAP bazuar në informacionin e qasshëm online

Të dhënat e publikuara sipas gjinisë shërbejnë si tregues matës për transparencën e institucioneve për sa i përket përpjekjeve drejt avancimit të barazisë gjinore. Si shembull, Ministria e Arsimit mund të përdorë të dhënat për nxënësit dhe studentët për të adresuar barazinë gjinore në edukim dhe mundësi karriere. Nga ana tjetër, ministritë që nuk publikojnë të dhëna të ndara, si Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Punëve të Jashtme, mund të humbasin mundësinë për të adresuar pabarazitë gjinore në fushat përkatëse. Pa këto të dhëna, është e vështirë të vlerësohet përfaqësimi gjinor dhe të bëhen ndërhyrje për përmirësimin e mundësive për gratë dhe vajzat.

Institucionet që ofrojnë të dhëna përkatëse, si Ministria e Kulturës dhe ajo e Financave, mund të rrisin përfshirjen gjinore, por përparimi i vërtetë kërkon transparencë të plotë. Publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë është një hap kyç për të garantuar barazi dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

Cilat institucione publike integrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në procese buxhetore?

Në Kosovë, nuk ekziston një përcjellje sistematike e shpenzimeve për barazi gjinore përgjatë proceseve të formulimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit.⁴³ Kjo ngase Kosova përdorë buxhetim sipas linjave buxhetore dhe jo sipas programeve ku do mund të gjurmoheshin shpenzimet sipas indikatorëve. Megjithatë, organizatat buxhetore mund të gjurmojnë shpenzimet sipas gjinisë së përfutuesve, për shembull, subvencionet dhe grantet për bujqësinë, politikat aktive të tregut të punës, për skemat e mbrojtjes sociale, për bursa arsimore, për strehimore që përdoren kryesisht nga gratë, për grante për të mbështetur bizneset në pronësi të grave, etj.

Instituti GAP ka bërë një analizë të përfshirjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë nga institucionet publike në proceset buxhetore duke filluar nga planifikimi e deri tek vlerësimi i ndikimit ex-post. Dokumentet buxhetore të cilat do duhej të ndërtoheshin duke u bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë janë buxheti vjetor përmes shtojcës për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) dhe Kornizës afatmesme të buxhetit dhe të shpenzimeve, plani vjetor, si dhe vlerësimet e ndikimit gjinor.

Dokumentacioni i propozim-buxhetit të qeverisë për vitin 2024 apo ai për vitin 2025 nuk përfshinte informacion mbi masat e politikave që synojnë avancimin e barazisë gjinore dhe informacion mbi vlerësimin e ndikimeve të politikave buxhetore në barazinë gjinore. Gjithashtu mungonte informacioni mbi pasqyrën e prioritetëve të qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore apo masat buxhetore që synojnë në promovimin e barazisë gjinore; si dhe vlerësimi i ndikimeve të politikave buxhetore në barazinë gjinore. Pra, nuk ka asnjë dokument të buxhetit të bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë. Njësoj vlen për treguesit e performancës në Ligjin për ndarjet buxhetore, të cilët mund të ndahen lehtë sipas gjinisë por kjo ndarje nuk është bërë asnjëherë deri më tani.⁴⁴

⁴³ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022.

⁴⁴ Shembull: Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024, Aneksi i Performancës sipas Sektorëve të Politikave, 2024

Përderisa të dhënat e ndara sipas gjinisë janë shumë të rëndësishme për planifikimin dhe draftimin e politikave, ato luajnë rol edhe në vlerësimin e ndikimit të këtyre politikave. Vlerësimi i Ndikimit Gjinator (VNGj) është një proces i integruar, që merr për bazë ndjeshmërinë e politikave ndaj gjinisë, përkatësisht ndërmerr veprime konkrete për të identifikuar ndikimin gjinator të politikave.⁴⁵ Si proces, vlerësimi i ndikimit gjinator kërkon një qasje të qartë analitike duke u bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe konkluzione e rekomandime që theksojnë qartë, mes gjetjeve të tjera, arritjet dhe dështimet në lidhje me barazinë gjinore.⁴⁶

Për sa i përket vlerësimeve të ndikimit gjinator të politikave publike, përfshirë buxhetin, asnjë nga institucionet publike të nivelit qendror apo atij lokal nuk e ka të publikuar në uebfaqet e tyre ndonjë dokument të tillë. Ndonëse Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar të kryej Vlerësime të Ndikimit Gjinator në kuadër të analizave post-legjislative, këto vlerësime nuk janë të qasshme online.⁴⁷

Tabela 2. Integrimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në dokumente buxhetore sipas institucionit të nivelit qendror

Institucioni	VNGj	BPGj	KAB	Raporti Vjetor
Ministria e Shëndetësisë	X	X	X	X
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	X	X	X	X
Ministria e Punëve të Brendshme	X	X	X	X
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	X	X	X	X
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	X	X	X	X
Ministria e Mbrojtjes	X	X	X	Pjesërisht
Ministria e Drejtësisë	X	X	X	Po
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	X	X	X	X
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	X	X	X	X
Zyra e Kryeministrit	X	X	X	X
Zyra e Presidentes	X	X	X	X
Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht	X	X	X
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	X	X	X	X

⁴⁵ Zyra e Kryeministrit, ABCj. Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore.

⁴⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Doracak për Procesin e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Ligjeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, fq. 54.

⁴⁷ Ibid

Ministria e Ekonomisë	X	X	X	X
Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal	X	X	X	X
Ministria e Punëve të Jashtme	X	X	X	X
Ministria për Komunitete dhe Kthim	X	X	X	X
Ministria e Zhvillimit Rajonal	X	X	X	X

Burimi: GAP bazuar në informacionin e qasshëm online

Zakonisht të dhënat e vetme të cilat ndahen sipas gjinisë dhe publikohen në uebfaqet e organizatave buxhetore janë të dhënat të cilat dërgohen me kërkesat për buxhet si pjesë e shtojcës për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Shtojca për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor sipas Qarkoreve të buxhetit, përfshinë tri tabela ku organizatat buxhetore paraqesin numrin e të punësuarëve sipas gjinisë, nivelet e pagave dhe ndarjen e subvencioneve dhe transfereve.⁴⁸ Sipas analizës së Institutit GAP, nga 38 komuna të Kosovës vetëm 32% e tyre kanë të publikuar shtojcën e BPGj për vitin 2024.⁴⁹ Gjithashtu, vetem 4 nga 38 komuna kanë të publikuar shtojcën e BPGj si pjesë e Kornizës Afatmesme të Buxhetit. Asnjë nga komunat nuk ka përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë në planin e tyre vjetor.

Tabela 3. Integrimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në dokumente buxhetore sipas komunave

Komuna	VNGj	KAB	BPGj	Raporti Vjetor
Deçan	X	X	Po	X
Dragash	X	X	X	X
Drenas	X	X	X	X
Ferizaj	X	X	Po	X
Fushë Kosovë	X	X	X	X
Gjakovë	X	Po	Po	X
Gjilan	X	X	X	X
Graçanicë	X	X	X	X
Hani i Elezit	X	X	Po	X
Istog	X	X	Po	X
Junik	X	Po	Po	X
Kaçanik	X	X	X	X

⁴⁸ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Qarkorja Buxhetore 2025/01.

⁴⁹ Instituti GAP. Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave, 2024.

Kamenicë	X	X	X	X
Klinë	X	X	X	X
Kllokot	X	X	X	X
Leposaviç	X	X	X	X
Lipjan	X	Po	Po	X
Malishevë	X	X	X	X
Mamushë	X	X	X	X
Mitrovicë e Jugut	X	X	X	X
Mitrovicë e Veriut	X	X	X	X
Novobërdë	X	X	X	X
Obiliq	X	X	X	X
Partesh	X	X	X	X
Pejë	X	X	X	X
Podujevë	X	X	Po	X
Prishtinë	X	X	X	X
Prizren	X	X	X	X
Rahovec	X	Po	Po	X
Ranillug	X	X	X	X
Shtërpcë	X	X	X	X
Shtime	X	X	Po	X
Skenderaj	X	X	Po	X
Suharekë	X	X	X	X
Viti	X	X	X	X
Vushtrri	X	X	Po	X
Zubin Potok	X	X	X	X
Zveçan	X	X	X	X

Burimi: GAP bazuar në informacionin e qasshëm online

Vetëm dy nga institucionet e pavarura të paraqitura në tabelën 4 kanë të publikuar shtojcën e BPGj si pjesë e kërkesave të tyre për buxhet. Gjithashtu, vetëm dy nga to, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, kanë të publikuar një vlerësim të Ndikimit Gjnor në uebfaqet e tyre. Ndërsa sa i përket raporteve vjetore, 30.5% e institucioneve të pavarura kanë të integruar në to të dhëna të ndara sipas gjinisë, dukshëm më shumë krahasuar me institucionet e tjera të nivelit qendror dhe atij lokal."

Tabela 4. Integrimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në dokumente buxhetore sipas institucionit të pavarur

Institucioni i pavarur	VNGj	BPGj	Raporti Vjetor
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	X	X	X
Adakemia e Shkencave dhe Arteve	X	X	Po
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	X	X	X
Agjencia Kosovare për Privatizim	X	X	X
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	X	X	X
Autoriteti i Aviacionit Civil	X	X	X
Agjencia Kundër Korrupsionit	X	X	X
Agjencia Shtetërore për Mbrotjen e të Dhënave Personale	X	X	X
Akademia e Drejtësisë	X	X	Po
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	X	X	X
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës	X	X	X
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike -Postare	X	X	X
Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit	X	X	X
Banka Qendrore e Kosovës	X	X	Po
Bordi i RTK-së	X	X	NA
Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë	X	X	X
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	X	X	X
Gjykata Kushtetuese	X	Po	Po
Institucioni i Avokatit Të Popullit	Po	Po	Po
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	X	X	Po
Këshilli Prokurorial i Kosovës	Po	X	Po
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	X	X	X
Këshilli për Ndihmë Juridike Falas	X	X	NA
Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin	X	X	X
Këshilli Kombëtar i Shkencës	X	X	Po
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	X	X	X
Komisioni i Pavarur për Media	X	X	Po
Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës	X	X	Po
Komisioni Kosovar i Konkurrencës	X	X	X

Komisioni Rregullativ i Prokurimit	X	X	X
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	X	X	X
Kostt- Operator Sistemi Transmisioni Dhe Tregu	X	X	X
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	X	X	X
Trusti i Kursimeve Pensionale	X	X	Po
Zyra e Rregullatorit për Energji	X	X	X
Zyra Kombëtare e Auditimit	X	X	X

Burimi: GAP bazuar në informacionin e qasshëm online

Ndërmarrjet publike në Kosovë nuk publikojnë asnjë të dhënë të ndarë sipas gjinisë, duke përfshirë informacionet për numrin e të punësuarve apo pagat, si dhe nuk publikojnë përfituesit e shërbimeve të tyre sipas gjinisë. Të dhënat e vetme të qasshme online për ndërmarrjet publike janë pjesëmarrja në borde dhe menaxhment. Kjo mungesë transparence pengon vlerësimin e barazisë gjinore në sektorin publik dhe krijon vështirësi në hartimin e politikave të efektshme për promovimin e barazisë.

Për sa i përket shqyrtimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, raportet e auditimit nuk kryejnë asnjë analizë gjinore. Kjo vlen edhe për auditimet e performancës që sipas Ligjit për Zyrën Kombëtare të Auditimit, të cilat mund të kryhen, për të vlerësuar ekonominë, efikasitetin ose efektivitetin e një aspekti të veçantë të veprimtarisë së të gjithë ose një pjese të çdo institucioni, programi ose aktiviteti.⁵⁰ Udhëzuesi i Auditimit të Performancës⁵¹ shpjegon metodologjinë në detaje, por nuk kërkon ndonjë analizë gjinore të bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë.

⁵⁰ PEFA. KOSOVO Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report, 2022

⁵¹ ZKA. Udhëzues për Përcjelljen e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës, 2021.

Përfundime dhe rekomandime

Ky raport thekson rëndësinë kritike të të dhënave të ndara sipas gjinisë për ndërtimin e politikave që promovojnë barazinë dhe drejtësinë sociale në Kosovë. Të dhënat e tilla mundësojnë identifikimin e pabarazive strukturore dhe adresimin e nevojave specifike të grave dhe burrave në fusha të rëndësishme si arsimit, shëndetësia dhe tregu i punës. Megjithëse ekzistojnë kërkesa ligjore për ndarjen e të dhënave sipas gjinisë, zbatimi mbetet sfidues për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale dhe shpesh në mungesë të vetëdijes për rëndësinë e këtyre të dhënave. Për më tepër, një analizë e të dhënave të qasshme tregon se publikimi i të dhënave gjinore nga institucionet mbetet i kufizuar dhe jo gjithmonë i orientuar drejt ndikimit konkret në politika. Pa përpjekje të qëndrueshme për mbledhjen dhe përdorimin efektiv të të dhënave sipas gjinisë, përparimi drejt barazisë gjinore dhe zhvillimit socio-ekonomik në Kosovë do të mbetet i ngadalësuar dhe jo i plotë. Instituti GAP, përmes kësaj analize, nxjerr në pah boshllëqet ekzistuese dhe kërkon veprime për të forcuar përdorimin e të dhënave gjinore si një mjet të domosdoshëm për hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të drejta.

Andaj, Instituti GAP rekomandon:

- Statistikat dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë duhet të krijohen, mirëmbahen dhe përdoren në mënyrë sistematike që të informojnë vendimet e politikave, nga të gjitha organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal. Këto të fundit duhet t'i bëjnë publike informatat mbi ndarjet e barazisë gjinore në një format lehtësisht të kuptueshëm.
- ASK në bashkëpunim me ABGj të draftoj dhe publikoj Indeksin e Barazisë Gjinore.
- Të krijohet një sistem i përbashkët i Qeverisë ku të gjitha institucionet vendosin të dhënat e tyre sipas sektorëve, të cilat mund t'i ndajnë lehtësisht sipas gjinisë.
- Të bëhet një vlerësim ex-ante para çdo politike i cili merr parasysh nevojat, prioritetet, dhe interesat e ndryshme të grave dhe burrave duke u bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë.
- Të shqiptohen gjopa për institucionet të cilat nuk mbledhin, përpunojnë dhe dorëzojnë në ASK të dhënat e ndara sipas gjinisë, sipas nenit 23 të Ligjit për Barazi Gjinore.


Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+383 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP përkrahët nga:

